

Përmbajtja

- 1: Veprimtari kryesore
- 2: Formimi Fillestar
- 3: Formimi Vazhdues
- 4: Platforma digjitale dhe shërbime online
- 5: Agjenda e muajit shkurt

Hyrje

Të nderuar,

Me kënaqësi ju prezantojmë numrin e parë të **Buletinit Informativ të Shkollës së Magjistraturës**, një instrument i ri komunikimi institucional, i cili synon të informojë në mënyrë të rregullt, të strukturuar dhe transparente mbi veprimtarinë e Shkollës.

Përmes këtij buletini, Shkolla e Magjistraturës synon të ndajë me të gjithë aktorët e përfshirë në programet e formimit fillestar dhe të vazhdueshëm informacion mbi aktivitetet trajnuese, veprimtaritë akademike dhe shkencore, bashkëpunimet institucionale, si dhe zhvillimet me interes për komunitetin e profesionistëve të drejtësisë.

Ky botim do të publikohet periodikisht dhe do të shërbejë si një platformë informuese që pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të Shkollës së Magjistraturës për forcimin e cilësisë së formimit profesional të magjistratëve por jo vetëm, si dhe për përbushjen e standardeve më të mira kombëtare dhe evropiane në fushën e drejtësisë.

1. Veprimtari kryesore

Gjatë muajit janar u zhvillua mbledhja e Komitetit Drejtues të Projektit të Binjakëzimit me Bashkimin Evropian, ku u raportua mbi realizimin e angazhimeve të projektit për tremujorin e fundit të vitit 2025, konkretisht:

- a. Kurikula e vitit të parë të Programit të Formimit Fillestar, e riformatuar tërësisht, e miratuar dhe në zbatim që prej tetorit 2025, përfshirë integrimin e aftësive jo-juridike (soft skills) në lëndët përkatëse, si rezultat i mbështetjes dhe bashkëpunimit me Qendrën e Studimeve Gjyqësore të Holandës;
- b. Trajnimi i të gjithë pedagogëve të brendshëm lidhur me metodologjinë e zbatimit të kurikulës së re, si dhe trajnimi i pedagogëve/ekspertëve me kohë të pjesshme në programin e formimit fillestar dhe të vazhdueshëm, në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Gjyqësore të Holandës;
- c. Mbështetja për automatizimin dhe digjitalizimin e Programit të Formimit të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës së Italisë;
- d. Rishikimi i plotë i tri fazave të Provimit Hyrës në Shkollën e Magjistraturës, realizuar me mbështetjen dhe bashkëpunimin e ekspertëve të Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës.



***Formim i vazhdueshëm, transparencë
institucionale dhe standarde bashkëkohore
për kandidatët dhe profesionistët e
drejtësisë.***



2. Formimi Fillestar Zemra e magjistratëve të rinj

Vijon me sukses procesi i Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë

Muaji janar 2026, në Formimin Fillestar, u karakterizua nga një sërë veprimtarish akademike dhe shkencore, të orientuara drejt forcimit të formimit profesional të kandidatëve për magjistratë dhe rritjes së cilësisë së procesit mësimor.

Ligjërata për Faik Konicën dhe takimi me pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm për përdorimin e platformave digjitale, si dhe për hartimin e tezave të reja të testit scan tron, përfaqësojnë dy shtylla të rëndësishme të misionit të institucionit: ruajtjen e trashëgimisë intelektuale dhe përshtatjen me sfidat bashkëkohore të arsimit juridik.

*Studimi sot, përgjegjësia e drejtësisë
nesër!*

Aktivitetet e muajit

- Zhvillimi i procesit mësimor nga e hëna në të premte, nga ora 8:30 deri në orën 16:50.
- Zhvillimi i praktikës paraprofesionale nga kandidatët për magjistratë të vitit të dytë.
- Zhvillimi i gjyqeve imituese nga kandidatët e vitit të dytë.
- Zhvillimi i praktikës profesionale nga kandidatët e vitit të tretë në gjykata dhe prokurori.
- Zhvillimi i vlerësimit të dytë në lëndën e gjyimit administrativ.
- Zhvillimi i vlerësimit përfundimtar në lëndën e etikës profesionale.

Viti i parë

Gjatë muajit janar vijoi procesi i mësimdhënies për kandidatët për magjistratë, ndihmës dhe këshilltarë ligjorë, si dhe për avokatë shteti, duke u aftësuar përmes praktikës dhe punës individuale nën drejtimin e pedagogëve të lëndëve përkatëse. Kandidatët iu nënshtruan dy vlerësimeve të rëndësishme: në lëndën e gjyimit administrativ dhe etikës profesionale.

Paralelisht me procesin mësimor, kandidatët për ndihmës dhe këshilltarë ligjorë zhvillojnë edhe praktikën profesionale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.



*Vlerësimi përfundimtar në
lëndën e etikës profesionale*



*Në fokus: Forcimi i përdorimit të
platformës SMVSHM dhe aplikacionit
Microsoft Teams për dokumentimin dhe
lehtësimin në komunikim gjatë
veprimtarisë së përditshme akademike, në
zbatim të Programit të Formimit Fillestar.*

Viti i dytë

Përmbyllja e lëndës së Kriminalistikës

Në kuadër të programit të formimit fillestar, u zhvillua ora e fundit e lëndës së Kriminalistikës për kandidatët për magjistratë. Ky sesion përmbyllës u fokusua në rifreskimin e koncepteve kryesore dhe trajtimin e rasteve praktike mbi rolin e kriminalistikës në procesin penal.



Një pjesë e leksionit u zhvillua edhe në “shtëpinë taktike”, mjedis trajnimi ku inskenohen vendet e ngjarjes, duke u dhënë kandidatëve mundësinë të



zbatojnë në praktikë njohuritë mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe dokumentimin e provave materiale.

Ora u karakterizua nga diskutime interaktive dhe analizë problematikash konkrete, duke kontribuar në forcimin e aftësive profesionale të kandidatëve për ushtrimin e funksionit të tyre të ardhshëm si magjistratë.

*Njeriu që e njeh ligjin, por nuk e zbaton atë,
më kujton atë që lëron tokën, por nuk i
hedh farë.*

Urtësi lindore

Zhvillimi i gjyqeve imituese

Gjyqet imituese u zhvilluan edhe këtë muaj nën drejtimin e pedagogëve përgjegjës. Kandidatët u angazhuan në mënyrë aktive në përzgjedhjen e fabulave, ndarjen e roleve dhe përgatitjen e akteve procedurale, duke simuluar realisht çdo fazë të procesit gjyqësor dhe duke forcuar aftësitë praktike, argumentuese dhe profesionale.




Çaste nga gjyqet imituese



Në gjyqet imituese u trajtuan fabula të ndryshme, si: konflikte pronësie dhe pezullim i ekzekutimit të titullit ekzekutiv; bashkëpronësia bashkëshortore, legalizimi i ndërtimeve pa leje dhe efektet juridike të veprimeve të njëanshme të bashkëshortit; interpretimi i kontratave të sipërmarrjes, përlogaritja e kamatave ligjore dhe kontraktore, padia dhe kundërpadia; si edhe përgjegjësia penale për vrasje në rrethana të cilësuar, e kryer në bashkëpunim.



tyre në punën e përditshme të këtyre institucioneve, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve përkatës, duke zhvilluar aftësi profesionale, etike dhe praktike të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve në sistemin e drejtësisë.



Çaste pune gjatë praktikës
profesionale

*“Është më mirë që dhjetë fajtorë të
shpëtojnë, sesa një i pafajshëm të
dënohet.”*

William Blackstone

Orari për muajin shkurt

Viti i tretë

Kandidatët e vitit të tretë vazhdojnë praktikën profesionale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (dhoma civile dhe penale), si dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku po njihen nga afër me funksionimin praktik të institucioneve të drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe, ata janë përfshirë në ndjekjen e çështjeve gjyqësore dhe procedurave hetimore, duke përfutur njohuri konkrete mbi zbatimin e legjislacionit material dhe procedural. Njëkohësisht, kandidatët po japin kontributin e

MUJ SHKURT													
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2			
8:30 - 11:20													
12:00 - 14:50													
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 17	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2			
8:30 - 11:20	GJA4	GJF6	GJC3	GJC3	Vlerësim 2	GJP	GJF6	GJA4	FUND DE				
12:00 - 14:50	GJK4		GJC	GJC	GJP	GJP		GJK4	DE				
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 18	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2			
8:30 - 11:20	GJA6	GJF8	GJC6	GJP6	GJ	GJC6	GJK4	GJA6	GJF8	GJK4			
12:00 - 14:50	GJA		GJC	GJC	GJP	GJC	4	GJA	Vlerësim 1	GJF			
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 19	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2			
8:30 - 11:20	GJA6	GJF4	GJC	GJP	GJP	GJC	GJF4	GJA6	Vlerësim 1	GJK			
12:00 - 14:50	GJA	GJK4	GJC	GJC	GJP	GJC	GJK4	GJA	Vlerësim 1	GJF			
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel	
Java 20	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2			
8:30 - 11:20	GJA4	GJF8	GJC6	GJP	GJP	GJC	GJK8	GJA4	GJF8	GJK8			
12:00 - 14:50			GJC	GJP	GJP	GJC							

3. Formimi Vazhdues Për një drejtësi më cilësore

Gjatë kësaj periudhe u realizuan 16 aktivitete trajnuese pjesë të moduleve:

- **Kundravajtjet Administrative** – [grupi i synuar, gjyqtarë administrativë]
- **Regjimi Juridik i Tatimit mbi Fitimin dhe TVSH-së në Republikën e Shqipërisë** – [grup i synuar, avokatët e shtetit]
- **Mashtrimet** – [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Krimi kibernetik** – [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Kontabiliteti dhe Raportimi financiar** – [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë, opgj]
- **Trajnime të posaçme 1-ditore si** “Kompetencat e drejtuesit të prokurorisë, zbatimi i vendimeve të GJK-së në gjykim etj.”.



Trajnim, datë 14.1.2026

Trajnimet u përqendruan në përditësimin dhe thellimin e njohurive mbi kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, analizën e praktikës gjyqësore, përfshirë praktikën e gjykatave shqiptare dhe atyre evropiane, zbatimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe zhvillimin e aftësive praktike nëpërmjet trajtimit të rasteve konkrete, diskutimeve

ndërdisciplinore dhe shkëmbimit të praktikave më të mira profesionale. Këto trajnime u ndoqën në total nga 458 pjesëmarrës (jo pjesëmarrës individual).



Trajnim, datë 19.1.2026

“Trajnimi vazhdues, urë lidhëse mes përvojës profesionale dhe sfidave të reja të drejtësisë; zhvillim profesional i vazhdueshëm për një drejtësi në hap me kohën.”



Trajnim, datë 28.1.2026

Veprimtari akademike&shkencore

Ligjëratë “Botëkuptimi Kushtetues i Faik Konicës” 9 janar 2026

Në kuadër të aktiviteteve akademike dhe përkujtimore për nder të 150-vjetorit të lindjes së Faik Konicës, u zhvillua një ligjëratë e posaçme për kandidatët që ndjekin Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Ligjëratat u mbajt nga Av. Agron Alibali, LL.M., nga University i Massachusetts, Boston, me temë “Botëkuptimi Kushtetues i Faik Konicës”.

Gjatë ligjëratës, u trajtuan në mënyrë të detajuar aspektet kryesore historike, filozofike dhe juridike të mendimit të Faik Konicës, duke u ndalur veçanërisht në rolin e tij në formësimin e ideve kushtetuese dhe shtetformuese shqiptare. Diskutimet theksuan kontributin e Konicës në promovimin e parimeve të shtetit të së drejtës, lirisë individuale, institucionalizmit dhe kulturës demokratike, si elemente thelbësore për zhvillimin e shoqërisë shqiptare.



Ligjëratat u shoqërua me diskutime interaktive me kandidatët, të cilët patën mundësinë të reflektojnë mbi aktualitetin e mendimit konician dhe ndikimin e tij në zhvillimet bashkëkohore të së drejtës kushtetuese. Ky aktivitet shërbeu si një mundësi e vlefshme për pasurimin e formimit teorik dhe

kulturor të kandidatëve, duke nxitur një qasje kritike dhe historike ndaj vlerave themelore të drejtësisë dhe shtetit kushtetues.

Bashkëpunime ndërkombëtare

Gjatë muajit **janar 2026**, Programi i Trajnimit Vazhdues zhvilloi **10 sesione trajnuese** në bashkëpunim me **Qendrën CEDI të Ambasadës Britanike në Tiranë**.



Trajnim, datë 8 janar 2026



Trajnim, datë 21 janar 2026

Një bashkëpunim veçanërisht i frytshëm ishte **mbështetja e projektit EU4LEA në realizimin e modulit të trajnimit “Krimi Kibernetik”**. Ky projekt mbështeti Shkollën e Magjistraturës jo

vetëm në aspektin logjistik, por edhe në atë të ekspertizës profesionale, duke garantuar një trajnim cilësor dhe praktik për kandidatët e formimit fillestar dhe të vazhdueshëm.

Në kuadër të këtij trajnimi, në panel u angazhuan dy ekspertë të huaj me përvojë të gjerë në fushën e së drejtës penale dhe procedurës penale, të cilët ofruan njohuri të avancuara dhe praktike mbi sfidat bashkëkohore të krimit kibernetik. Ekspertiza e tyre përfshinte, ndër të tjera, çështje që lidhen me krimin e organizuar dhe mbrojtjen e të miturve, si dhe krimet e lehtësuara nga teknologjia, hetimet online, forenzikën digjitale dhe administrimin e provës elektronike ndërkufitare.

Ky trajnim përfaqësoi një mundësi të vlefshme për magjistratët për të njohur praktikën më të mira ndërkombëtare, për të përvetësuar aftësi të specializuara në hetimin e krimeve digjitale, dhe për të forcuar kapacitetin e tyre profesional në përballjen me sfidat moderne të drejtësisë penale.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, projekti **EU4LEA po vijon punën për hartimin e një kurrikule të posaçme mbi krimin kibernetik**. Kjo iniciativë ka për qëllim jo vetëm zhvillimin e njohurive të thelluara për kandidatët dhe profesionistët e sistemit të drejtësisë, por edhe forcimin e qëndrueshëm të kapaciteteve profesionale në këtë fushë komplekse dhe në zhvillim të shpejtë.

Kurikula e re do të ofrojë një program të strukturuar trajnimesh, duke kombinuar njohuritë teorike me aftësitë praktike të nevojshme për hetimin dhe ndjekjen e krimeve kibernetike. Ky program synon të krijojë një platformë të qëndrueshme të formimit profesional, që mund të përshtatet vazhdimisht me sfidat e reja teknologjike dhe me nevojat e praktikës së drejtësisë, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit, integritetit dhe përgatitjes së profesionistëve të drejtësisë për të përballuar krimin e organizuar dhe sfidat digjitale.



Trajnim, datë 20 janar 2026

“Krimi kibernetik nuk njeh kufij, ndaj as drejtësia nuk mund të mbetet e kufizuar.”

Europol

“Drejtësia nuk është thjesht zbatim i ligjit, por kërkim i së drejtës.”

Ciceroni



Trajnim, datë 23 janar 2026

4. Platforma digjitale dhe shërbime online

Shkolla e Magjistraturës vazhdon të ofrojë platforma digjitale për formimin fillestar të kandidatëve për magjistratë, si dhe për formimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, duke kontribuar në aksesin elektronik të burimeve dhe materialeve mësimore.

Platforma digjitale

Shkolla e Magjistraturës ofron disa platforma për formimin fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe formimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve:



SMVSHM



eCommentary



Biblioteka Digjitale



Forum



Teknologjia në shërbim të profesionalizmit

Sistemit të menaxhimit të veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës (SMVSHM) shërben si shtylla kurriore administrative dhe akademike, duke mundësuar regjistrimin e kandidatëve, gjurmimin e progresit akademik, menaxhimin e kurikulave dhe procesin e vlerësimit. Ai lehtëson komunikimin ndërmjet administratës, pedagogëve dhe kandidatëve, duke garantuar transparencë dhe efikasitet në çdo hap të formimit.

Platformat Digjitale

SMVSHM (Sistemi Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës): <http://smvshm.magjistratura.edu.al>

eLearning: <http://moodle.magjistratura.edu.al/>

Komentari Elektronik: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/>

Baza e të dhënave: <http://www.jurisdocsmagjistratura.edu.al/>

Lojëra Interaktive: <https://magjistratura.edu.al/sq/programe-and-formime/lojera-interaktive>

Biblioteka Digjitale: <https://biblioteka.magjistratura.edu.al/>

Forumi i Shkollës së Magjistraturës: <https://forum.magjistratura.edu.al/>

Activate Windows
Go to Settings to activate Windows.

Viti 2026 është viti i tretë akademik që Shkolla e përdor SMVSHM-në për regjistrimet online të kandidatëve, pranimin dhe vlerësimin e dokumenteve të konkurrentëve nga Komisioni i Shkollës si dhe komisionet e Këshillave apo Avokatit të Shtetit si dhe integrimin e rrjedhshëm të kandidatëve fitues nga konkursi deri te Formimi Fillestar (mungesat, evidencat, lëndët akademike, detyrat online etj.)

“Formimi digjital forcon vazhdimësinë e dijes dhe cilësinë e profesionalizmit.”

Po ashtu, janë zhvilluar ndryshime të rëndësishme në ristrukturimin e Formimit Vazhdues në SMVSHM, duke lehtësuar dhe organizuar më mirë punën e Sektorit të Formimit Vazhdues, integrimin më të rrjedhshëm të kandidatëve nga Formimi Fillestar në atë Vazhdues, si dhe në aksesimin më të lehtë të sistemit nëpërmjet llogarive Microsoft 365 – llogari të cilat janë krijuar për çdo subjekt trajnues apo i përfshirë në programet e Shkollës.

Biblioteka Digjitale ofron një arkivë të gjerë dhe të aksesueshme online me literaturë juridike, vendime gjyqësore, module trajnimi dhe botime shkencore. Kjo platformë u lejon magjistratëve të kenë qasje në kohë reale në burimet më të fundit të kërkimit ligjor, duke eliminuar barrierat fizike dhe nxitur vetë-edukimin e vazhdueshëm.

Përdorimi i platformës **Microsoft 365** ka shënuar një kthesë rrënjësore në mënyrën se si Shkolla e





Magjistraturës operon, duke krijuar një ekosistem digjital të integruar që tejkalon thjesht komunikimin video.

metodologjive të mësimdhënies dhe koordinimin e kurrikulave.

Portofoli digjital i kandidatit: Një risi kyçe është krijimi i **portofolit të kandidatit**. Ky është një seksion i dedikuar ku arkivohen në mënyrë të strukturuar të gjitha materialet e prodhuara nga kandidati gjatë rrugëtimit të tij akademik (detyra, kazuse etj.). Ky portofol shërben si një dëshmi digjitale e rritjes profesionale dhe është lehtësisht i aksesueshëm për rishikim akademik në çdo kohë.

Rritja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit: Platforma ka krijuar një urë lidhëse të pandërprerë mes të gjithë aktorëve. Administrata menaxhon proceset me efikasitet më të lartë, ndërsa kandidatët dhe pedagogët ndërveprojnë në kohë reale. Ky bashkëpunim nuk kufizohet vetëm në marrëdhënien pedagog-student; Microsoft 365 ka nxitur bashkëpunimin horizontal mes vetë pedagogëve, duke lehtësuar shkëmbimin e



Integrimi me SMVSHM dhe Single Sign-On (SSO): Për të garantuar një përvojë sa më të thjeshtë dhe të sigurt (user-friendly), Microsoft 365 është integruar plotësisht me Sistemin e Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës (SMVSHM). Nëpërmjet teknologjisë **Single Sign-On (SSO)**, përdoruesit mund të aksesojnë të gjitha platformat (e-mail-in, klasat virtuale në Teams, Forumin dhe të dhënat administrative në SMVSHM) me një grup të vetëm kredencialesh. Kjo rrit sigurinë e të dhënave dhe eliminon nevojën për mbajtjen e shumë fjalëkalimeve, duke unifikuar identitetin digjital të çdo magjistrati.

“Teknologjia kërkon jo vetëm aftësi teknike, por edhe përgjegjësi profesionale.”



AGJENDA E MUAJIT SHKURT Kalendari i trajnimeve

SHKURT 2026				
	MODUL c.4 “PROKURIMI PUBLIK DHE KONKURRENCA”			
1.	Konflikti i interesit, masat parandaluese dhe zgjidhja e rasteve të konfliktit që lindin gjatë procesit të prokurimit, në funksion të shmangies së shtrembërimit të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Çështjet e konkurrencës në sektorët e rregulluar, sektorët e rregulluar dhe parimi i konkurrencës së lirë, aksesit në treg, konkurrenca dhe çmimet e përcaktuara, diskutimi i rasteve praktike në fushën e energjisë dhe telekomunikacionit. Çështjet e konkurrencës në tregun digjital, natyra e tregut digjital, pozitat dominuese, kontrolli i grupimeve, balanca midis konkurrencës dhe zhvillimit teknologjik, diskutimi i rasteve praktike. <i>Target grupi parësor: Gjyqtarë të gjykatave administrative dhe prokurorë</i>		Ekspertë: Blerona Hasa Reida Kashta Lehtësues: Maela Alicanaj	2 shkurt 2026
	MODUL a. 9 “KORRUPSIONI”			
2.	Korrupsioni dhe prokurimi publik; Palët që mund të përfshihen në veprime korruptive aktive ose pasive dhe metodat për hetim dhe gjykim në këto raste. Target grupi parësor: Prokurorë të SPAK dhe Gjyqtarë të GJKKO		Ekspertë: Ylli Pjetërnikaj Bledar Maksuti Lehtësues: Adnan Hoxha	3 shkurt 2026
3.	MODULI MBI KONTABILITETIN Kontabiliteti dhe Raportimi Financiar për Gjyqtarët dhe Prokurorët: - parimet kontabël dhe raportimi financiar; - interpretimi i përgjigjeve apo raporteve të ekspertëve kontabël në kontekstin ligjor; - vlerësimi i situatave ku mungon një përgjigje e besueshme kontabël apo teknike		Ekspertë: Artan Xhiani Neritan Sota Lehtësues Elvana Çiçolli	4 shkurt 2026
	INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE ETIKA E PROKURORIT			
4.	Parimet etike dhe kufijtë në përdorimin e IA për hetime penale (analizë e provave digjitale, parashikim i sjelljes kriminale, etj.), Të drejtat e palëve dhe standardet e drejtësisë kur përdoren mjete të automatizuara, Rreziku i mbështetjes së tepruar në algoritme në fazat e ndjekjes penale dhe prokurorisë, Detyrimi i prokurorit për kujdes të shtuar në verifikimin e rezultateve të IA		Arben Isaraj Olkeda Lice Lehtësues Olger Rumnici	5 shkurt 2026
5.	Trajnim 1 ditor Menaxhimi i dosjes hetimore dhe përgatitja për gjykim. Organizimi logjik i provave dhe strukturimi i akuzës.		Ekspertë: Kreshnik Ajazi Henrik Ligori Lehtësues: Ajkuna Anxhaku	6 shkurt 2026
	MODUL c.5 “PENSIONET DHE SIGURIMET SHOQËRORE”			
6.	Njohja e vjetërsisë së punë për efekt pensioni pleqërie të bashkëshorteve/bashkëshortëve të papunë të ushtarakëve që trajtohen me pagesë për këtë shkak në zbatim të kuadrit ligjor të trajtimit të ushtarakëve.		Ekspertë: Arbena Ahmeti Elvana Çiçolli Lehtësues: Gentian Marku	9 shkurt 2026



Buletin informativ Shkolla e Magjistraturës

Janar 2026
Nr. 1

7.	Trajnim 1 ditor Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në gjykim. Rasti i normave të shfuqizuara që presin miratimin nga ligjvënësi.		Ekspertë: Artur Kalaja Arbena Ahmeti Lehtësues: Ejona Lazellari	10 shkurt 2026
8.	Natyra juridike e kërkimeve, vërtetim fakti juridik dhe padia e vërtetësisë së marrëdhënies juridike apo të një dokumenti, ngjashmëritë dhe dallimet e tyre në gjykimin civil dhe atë administrativ.		Ekspertë: Gentian Medja Sokol Pina Lehtësues: Adrian Shega	10 shkurt 2026
	MODUL a.8 “NARKOTIKËT”		Ekspertë: Qemal Zaimi Andi Pogaçe Lehtësues: Orgent Nazaj	11 shkurt 2026
9	Trafikimi i narkotikëve. Format e kryerjes së veprës penale sipas nenit 283/a të Kodit Penal. Komplexiteti i hetimit të veprës penale të trafikimit. Konfiskimi i produkteve të veprës penale.		Ekspertë: Idlir Peçi Viktor Gumi Lehtësues: Ema Shaholli	12 shkurt 2026
10.	Trajnim 1 ditor E drejta e shtetësisë dhe të drejtat e minoriteteve.		Ekspertë: Mariana Semini Remzie Istrefi Lehtësues: Aida Bushati	13 shkurt 2026
11.	Trajnim 1 ditor Juridiksioni dhe ligji i zbatueshëm në rastet e cenimit të të drejtave të personalitetit në hapësirën digjitale: Analizë krahasuese e jurisprudencës së GjED-së dhe shteteve anëtare të BE-së. Impaktet për sistemin gjyqësor shqiptar në kontekstin e zhvillimeve evropiane		Ekspertë: Sokol Berberi Markelian Koça Lehtësues: Iva Çorri (Zemani)	16 shkurt 2026
12.	Trajnim 1 ditor Trajnim i dedikuar për shkrimin, kërkimin dhe arsyetimin ligjor apo çështje të tjera të administrimit gjyqësor me fokus njësinë ligjore në bashkëpunim me SHM. (Trajnim për KLGJ)		Ekspert: Ervin Pollozhani Lehtësues: Ejona Lazellari	17 shkurt 2026
13.	Trajnim 1 ditor Markat tregtare, dizajnet industriale dhe treguesit gjeografikë WIPO.	DPPI	Ekspertë: Julian Zonja Ledina Rizo Lehtësues: Ervisa Hyka	18 shkurt 2026
14.	Trajnim 1 ditor Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit si Drejtues i Prokurorisë. Dallimi i këtyre shkeljeve nga vlerësimi i veprimtarisë së punës së drejtuesit të Prokurorisë si kompetencë e Këshillit.	ILD	Ekspertë: Kostaq Beluri Erind Mërkuri Lehtësues: Elena Pelushi	19 shkurt 2026
15.	Trajnim 1 ditor Pavarësia procedurale e prokurorit si dhe kuadri ligjor nënligjor që rregullon marrëdhëniet e tyre me drejtuesin e prokurorisë, prokurorët e Apelit, si dhe Prokurorin e Përgjithshëm.	ILD		



Buletin informativ Shkolla e Magjistraturës

Janar 2026
Nr. 1

16.	Tema 3: Komunikimi institucional i magjistratit, si element kyç për një proces ligjor të drejtë dhe efektiv. Rëndësia e komunikimit në përcjelljen e mesazheve të duhura te përdoruesi i gjykatës dhe publiku, me qëllim forcimin e besimit në sistemin e drejtësisë.		Ekspertë: Mirela Bogdani Ilir Rusi Lehtësues: Armando Bora	20 shkurt 2026
17.	Trajnim 1 ditor E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të ligjit të ri nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.		Ekspertë: Besnik Dervishi Altina Nasufi Lehtësues: Hazbi Balliu	23 shkurt 2026
	MODUL a.10 “VIKTIMA DHE I MITURI NË PROCESIN PENAL”		Ekspertë: Ornela Naqellari Elida Kackini Lehtësues: Elsa Miha	24 shkurt 2026
18.	1. Kuptimi i viktimës nga vepra penale. Personat juridikë dhe organet publike në cilësinë e viktimave nga vepra penale. Të drejtat e viktimës nga vepra penale, viktimat akuzuese. Ushtrimi i të drejtave gjatë fazave të procesit penal dhe pasojat e mosrespektimit të tyre. Problematikat dhe praktika gjyqësore.		Ekspertë: Albana Shtylla Vojsava Osmanaj (Kola) Lehtësues: Ina Barjamaj	25 shkurt <u>2026</u>
19.	MODUL b.4 “MARRËDHËNIET E PUNËS” Përdorimi gjyqësor i standardeve ndërkombëtare të punës në Shqipëri.		Ekspertë: Albana Shtylla Enerjeta Shehaj Lehtësues: Jonida Çollaku	26 shkurt 2026
20.	Marrëdhëniet e punës dhe kompetenca e gjykatës administrative në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve. Kufijtë ndërmjet juridiksionit gjyqësor administrativ dhe atij civil në mosmarrëveshjet e punës me elementë publikë, në kontratat administrative, etj. Standardet për dallim dhe pasojat në juridiksion.		Ekspertë: Valbona Vata Vjosa Zaimi Lehtësues: Suela Xhani	27 shkurt 2026
21.	MODUL b.2 “ÇËSHTJE TË SË DREJTËS FAMILJARE DHE TË MITURVE” Kujdestaria alternative me bazë familjen dhe ndarja e eksperiencave dhe vendimeve gjyqësore për zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës. Të drejtat e fëmijëve.			



Për muajin shkurt janë planifikuar:

- 21 trajnime të formimit vazhdues
- Zhvillimi i pesë vlerësimeve në lëndët e Formimit Fillestar
- Regjistrimi në provimin e pranimit për vitin akademik 2026-2027.

Numri i vendeve vakante për pranimin në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2026-2027, do të jetë 17 kandidatë për magjistratë, nga të cilët 10 profili gjyqtarë, 7 profili prokurorë, si dhe 7 kandidatë për avokat shteti.

Regjistrimi i kandidatëve për magjistratë do të bëhet në sekretarinë shkencore të Programit të Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në periudhën 2 shkurt - 28 shkurt 2026, nga ora 9.00 – 14.00 (Godina e re, “Poli i Drejtësisë”, rruga “Ana Komnena”, Tiranë).



SHKOLLË E MAGJISTRATURËS
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Rreth nesh

Programet & Formime

Programi i transparencës

Të tjera

Kërko...

» Konkursi i provimit të pranimit

Konkursi i provimit të pranimit

THIRRJE PËR APLIKIME PËR PROVIMIN E PRANIMIT
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Ju ftojme të vizitoni rregullisht faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës për informacion të përditësuar mbi programet dhe veprimtaritë tona.

Me respekt,

Shkolla e Magjistraturës
www.magjistratura.edu.al

E-mail: info@magjistratura.edu.al